



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi Komunës së Prizrenit

Nr.001/011 - 151393

Më: 13 nëntor 2024

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2, pika d), dhe nenit 17, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 20 dhe nenit 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës Nr.01/011-5643, i datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2024, miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË ARSIMIT 2025- 2027

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit për periudhën 2025-2027.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë Zhvillimor Komunal i Arsimit për periudhën 2025-2027.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, si dhe drejtoritë, sektorët tjerë të përfshira në këtë plan.

Neni 4

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I ARSIMIT 2025-2027

Prizren, 2024

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Përmbledhje ekzekutive | 3 |
| 1. Hyrja | 5 |
| 2. Sfondi..... | 7 |
| 3. Qasja strategjike..... | 27 |
| 3.1. Vizioni dhe misioni..... | 27 |
| 3.2. Objektivat strategjike dhe masat | 28 |
| 3.3. Analiza e rrezikut..... | 39 |
| 4. Plani i veprimit dhe buxheti..... | 40 |
| 5. Korniza për vlerësimin e performancës | 69 |

Lista e shkurtesave

| | |
|---------------|---|
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| IPEH | Institucioni Privat i Edukimit të Hershëm |
| IPK | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| KKK | Korniza e Kurrikulës së Kosovës |
| MAShT | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë |
| OJQ | Organizata joqeveritare |
| OS | Objektiva strategjike |
| PSAK | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë |
| SBAShK | Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe e Shkencës e Kosovës |
| SIA | Spektori i Inspektoratit të Arsimit |
| SWOT | Sukseset, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet |
| ZhPM | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve |

Përmbledhje ekzekutive

Plani Zhvillimor i Arsimit për Komunën e Prizrenit 2025-2027 është produkt i punës së përbashkët të personelit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, të drejtorëve të shkollave, mësimitdhënësve, të komunitetit të prindërve dhe të organizatave joqeveritare. Ky plan zhvillimor komunal u hartua përmes një procesi të strukturuar mirë dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, duke u mbështetur në nevojat reale për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prizrenit, si dhe në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2022-2026, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Plani Zhvillimor i Arsimit për Komunën e Prizrenit është përqendruar në shtatë fusha tematike: 1) Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës; 2) Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore; 3) Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla; 4) Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimitdhënie cilësore; 5) Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla; 6) Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm; dhe 7) Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës, si dhe janë mbledhur të dhëna që shërbyen për qëllime të planifikimit. Pesë fushat e para tematike përkrijnë me pesë fushat e cilësisë, gjersa dy fushat e fundit janë përzgjedhur nga komuniteti arsimor i Prizrenit si fusha të rëndësishme të veçantë të cilave duhet dhënë prioritet. Në vijim u formuluan vizioni dhe misioni i Planit Zhvillimor të Arsimit për periudhën 2025-2027.

Vizioni: Qytetarë të përgatitur me shprehje të të nxënimit gjatë gjithë jetës, të mveshur me kompetenca dhe vlera të qytetarisë aktive, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Misioni: Sistem gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës i arsimit, me menaxhim cilësor dhe mësimitdhënës të përgatitur, me mjedise krijuese dhe kushte që sigurojnë edukim dhe arsim cilësor të fëmijëve.

Plani Zhvillimor i Arsimit ka shtatë objektiva strategjike, nga një për secilën fushë me interes:

- OS1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës
- OS2. Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore
- OS3. Përmirësim domethënës i mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla
- OS4. Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimitdhënie cilësore
- OS5. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënimit në shkolla
- OS6. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm
- OS7. Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës

Për secilin objektiv strategjik janë përcaktuar masat që çojnë në arritjen e tij, gjithsej 34 syresh. Po ashtu është prezantuar një analizë e rrezikut që identifikon masat parandaluese për rreziqet e perceptuara për zbatimin e Planit Strategjik.

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit, duke filluar nga viti 2025 deri në vitin 2027. Vlera e mjeteve të nevojshme për

zbatimim e Planit, pa llogaritur shpenzimet operative të zakonshme, kap shumën prej € 5.472.800 Plani është që disa shpenzime për realizimin e Planit Zhvillimor të mbulohen nga burimet vetanake të Komunës, ndërsa disa të tjera nga Buxheti i Kosovës ose donatorët.

Dokumenti përfundon me kornizën për vlerësimin e performancës, e cila përcakton treguesit mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi për secilin nga shtatë objektivat e planit zhvillimor dhe si e tillë përmban caqet që duhet arritur gjatë periudhës së zbatimit të Planit, si dhe gjendjen e tanishme të treguesve.

1. Hyrja

Plani për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Prizrenit 2025-2027 u hartua pas aprovimit të një serie të dokumenteve të rëndësishme legjislative dhe strategjike në nivel qendror, si: Ligji për Edukimin e Hershëm, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin në Komuna, Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026, Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Strategjisë për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2022-2026, etj. Zhvillimi i planit u realizua edhe si vazhdimësi e nismave komunale për përparimin e sistemit të arsimit. Periudha zbatuese e Planit të DKA së Prizrenit 2012-2016 dhe Planit për Zhvillimin profesional të mësimdhënësve 2012-2015 dhe së fundmi Plani i Veprimit i DKA-së 2017-2021 vetëm kishte përfunduar, prandaj hartimi i këtij plani ishte nevojë dhe njëkohësisht mundësi për të siguruar një vazhdimësi të punës në planifikimin e aktiviteteve në sektorin e arsimit. Përvoja e fituar gjatë planifikimeve të mëhershme bëri që Komuna e Prizrenit të përgatisë planin 5-vjeçar për zhvillimin e arsimit në këtë komunë.

Plani u hartua me qëllim që të përcaktohen kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit gjatë periudhës 2025-2027, të cilat do të bashkërendisin politikat arsimore të nivelit qendror me prioritetet zhvillimore të këtij sektori të përcaktuara në nivelin komunal. Për të siguruar harmonizimin e këtij plani me politikat e nivelit qendror dhe reflektimin e interesave komunale, hartimi i planit u realizua përmes organizimit të një procesi planifikimi me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha strukturave me interes në sferën e arsimit. Zyrtarë të DKA-së dhe MASHT, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të komunitetit të prindërve kontribuan në mënyrë aktive në hartimin e këtij plani, i cili reflekton konsensusin e të gjitha palëve me interes lidhur me kahet e zhvillimit të arsimit në Komunën e Prizrenit.

Procesi i planifikimit është drejtuar nga Grupi për Planifikim i themeluar nga DKA e Prizrenit dhe është ndihmuar nga konsulentë e ofruar. Procesi u karakterizua me pjesëmarrje të gjerë të palëve me interes dhe konsultime të vazhdueshme, ndërsa u zhvillua në katër faza kryesore:

Faza e parë: Organizimi i procesit të planifikimit dhe mbledhja e të dhënave

Gjatë kësaj faze përgatitore u realizuan disa aktivitete që kishin për qëllim sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe profesional në hartimin e këtij plani. Në fillim DKA caktoi grupin bërthamë në përbërje të zyrtarëve të DKA dhe drejtorëve të shkollave, të cilët do të ishin përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të planifikimit. Në punëtoritë e organizuara ky grup u njoftua me procesin e planifikimit dhe fazat e realizimit të tij. Në këto punëtori grupi bërthamë vendosi të hartojë një plan gjithëpërfshirës të sektorit të arsimit, i cili do të mundësonte harmonizimin e iniciativave të nivelit qendror me prioritet dhe nevojat komunale në këtë sektor. Më pas, grupi caktoi fushat për analizë të gjendjes dhe identifikoi burimet për sigurimin e informatave të nevojshme për planifikim. Fushat për analizë u përzgjedhën sipas Udhëzimit Administrativ 23/2016 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit, duke i shtuar dhe dy fusha të tjera për të cilat është konsideruar se duhen trajtuar viteve që vijnë. Me qëllim që gjatë hartimit të planit të sigurohej përfaqësim i grupeve të ndryshme të interesit brenda komunës, DKA caktoi edhe grupin punues për hartimin e planit të përbërë nga zyrtarë të DKA, të MASHT, përfaqësues të subjekteve politike që janë pjesë e Asamblesë Komunale të Prizrenit, përfaqësues të shoqërisë civile, SBASHK, Këshillit të Prindërve, etj. Grupi bërthamë së bashku me grupin punues përbëjnë ekipin planifikues, të cilët do të ndihmojnë në finalizimin e planit për zhvillimin e arsimit.

Faza e dytë: Analiza e gjendjes në sektorin e arsimit

Në punëtoritë e organizuara është bërë prezantimi i fushave për analizë të gjendjes, përshkrimi i tyre, si dhe informatat e mbledhura gjatë fazës përgatitore. Të dhënat e mbledhura, si dhe kontributet e pjesëmarrësve gjatë analizës SWOT mundësuan një analizë gjithëpërfshirëse dhe

kritike të gjendjes së arsimit në nivelin parauniversitar në komunën e Prizrenit. Një analizë e tillë nxori në pah sukseset dhe dobësitë që e karakterizojnë këtë komunë, si dhe evidentoi mundësitë për zhvillim më të suksesshëm në të ardhmen duke pasur kujdes rreziqet që mund të shoqërojnë një proces të tillë. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që planifikimi të përqendrohet në shtatë fusha kryesore që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsimin parauniversitar, menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollave, zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, zbatimin e kurrikulës së re, sigurimin e cilësisë në procesin mësimor, edukimin e hershëm, si dhe arsimin profesional.

Faza e tretë: Përcaktimi i rezultateve dhe planit të veprimit

Analiza e gjendjes në sektorin e arsimit mundësoi identifikimin e fushave me prioritet të punës së DKA-së gjatë periudhës 2025-2027. Në punëtoritë është përcaktuar synimi i përgjithshëm dhe qëllimi i planit për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit, rezultatet, aktivitetet për arritjen e tyre, si dhe janë përcaktuar treguesit për matjen e progresit. Në fund të punëtorisë është bërë analiza e faktorëve të rrezikut, si dhe identifikimi i masave për parandalimin e tyre. Për të mundësuar monitorim efikas të realizimit të aktiviteteve dhe arritjes së treguesve, në plan është prezantuar në formë të tabelës edhe korniza për vlerësimin e performancës. Më pas është hartuar një plan veprimi, në të cilin u përcaktua zbatimi i aktiviteteve sipas viteve, si dhe është realizuar një vlerësim preliminar i buxhetit të nevojshëm për zbatim të planit duke u bazuar në kapacitetet buxhetore të komunës, si dhe mundësitë e sigurimit të burimeve alternative të buxhetit nga partnerët zhvillimor që bashkëpunojnë me të.

Faza e katërt: Hartimi i planit për zhvillimin e arsimit

Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit të planifikimit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i Planit Zhvillimor të Arsimit, i cili, pasi u shqyrtua nga Grupi për Planifikim i DKA, mori formën e draftit përfundimtar.

2. Sfondi

2.1. Arsimi në Komunën e Prizrenit

Analiza e gjendjes


Infrastruktura e Objekteve Arsimore në Komunën e Prizrenit

Në komunën e Prizrenit, numri i nxënësve që frekuentojnë në shkolla është 26355, të shpërndarë në 87 shkolla, prej të cilave 65 shkolla janë në zonat rurale dhe 22 shkolla janë në zonat urbane.

Hapësira totale e objekteve shkollore ka një sipërfaqe prej 140750,911, ndërsa hapësira funksionale shkollore është 50337,53. Në graf.1 paraqitet se vetëm 36% e hapësirave shkollore janë funksionale, apo sipërfaqe të klasave.

Grafiku 1. Sipërfaqja e hapësirave shkollore

Sipërfaqja e objekteve shkollore



Të dhënat tregojnë se vetëm 25%, apo 21 shkolla në komunën e Prizrenit janë të pajisura me kabinete të kompletuara (12 në zonat rurale dhe 9 në zonat urbane).

Numri më i lartë i shkollave posedon fusha të jashtme të sportit me 55%, ndërsa vetëm 36% e shkollave kanë salla të edukatës fizike të plotësuara me vegla dhe mjete.


15 nga 87 shkolla janë të pajisura me vegla të edukatës muzikore, ku 67% e këtyre shkollave iu takojnë zonave rurale.

Sipas të dhënave nga DKA Prizren, nga gjithsej 87 shkolla në komunën e Prizrenit, 87% të shkollave janë të pajisura me kompjuterë dhe 35% janë të pajisura me tablete. Grafikonin 2. në vijim paraqet shpërndarjen e kompjuterëve sipas zonave rurale, rurale dhe paralelet si dhe ato urbane.

Në komunën e Prizrenit janë vetëm dy shkolla të cilat posedojnë më shumë se 100 kompjuterë, ndërsa 60% e shkollave posedojnë 0-9 kompjuterë.

Shpërndarja e pajisjeve kompjuterike në mes zonave rurale dhe urbane është e realizuar proporcionalisht sipas raportit të shkollave rurale/urbane. 67% e shkollave që posedojnë kompjuterë i takojnë shkollave rurale.

Grafiku 2. Numri i shkollave të pajisura me kompjuterë




Në komunën e Prizrenit gjithsej janë 12 KDSH të trajnuar, prej tyre 8 KDSH të trajnuar janë në zonat rurale dhe 4 KDSH të trajnuar janë në zonat urbane.

Siguria e Objekteve Arsimore në Komunën e Prizrenit

Nga të dhënat e sigurisë, 67 shkolla apo 77 % e shkollave kanë qasje për makineritë e rënda të sigurisë dhe të emergjencave. Kjo bën që 22232 nxënës të jenë më të sigurt. Këto shkolla kryesisht ndodhen në zonat rurale (76%).


Shkollat në komunën e Prizrenit variojnë nga 2 deri në 4 kate, ndërsa 47% e objekteve shkollore u takojnë objekteve me lartësi 2 katëshe.

Grafiku 3. Numri i aparateve kundër zjarrit nëpër shkolla



Ky grafikon paraqet që 66 shkolla posedojnë aparate kundër zjarrit, ndërsa 11 shkolla të tjera nuk posedojnë aparate kundër zjarrit.

Grafiku 4. Shkollat urbane/rurale sipas funksionalizimit të sigurisë



Komuna e Prizrenit shtrihet në jugperëndim të Republikës së Kosovës në sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % të territorit të Kosovës) dhe përbëhet nga 76 vendbanime me 220,776 banorë¹. Njëra ndër veçoritë e Komunës së Prizrenit është karakteri multi-etnik i saj, pasi në të bashkëjetojnë komunitete të ndryshme, si: shqiptarë, boshnjakë, turq, goran, romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Një karakteristikë e tillë reflektohet dhe në të gjitha nivelet e arsimit duke filluar nga edukimi parashkollor e deri në arsimin e lartë. Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i fëmijëve, nxënësve dhe studenteve sipas nivele arsimore është dhënë në tabelën 1. Përveç institucioneve publike, në Komunë e Prizrenit funksionojnë dhe disa institucione private të nivelit parauniversitar dhe të arsimit të lartë, për të cilat ka të dhëna të pjesshme.

Tabela 1. Numri i nxënësve në institucionet publike të komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2023 – 2024

| Niveli i edukimit të hershëm | | Niveli fillor | | | | | Niveli i mesëm i ulët | | | | Niveli i mesëm i lartë | | |
|---|-------------|---------------|------|------|------|------|-----------------------|------|------|------|------------------------|--------------|------|
| Parashkollorë | Parafillorë | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
| 172 | 1571 | 2066 | 2003 | 2022 | 2144 | 2053 | 2190 | 2035 | 2057 | 2092 | 1329 | 1342 | 1275 |
| Gjithsej | | | | | | | | | | | | | |
| Në nivelin e edukimit të hershëm | | | | | | | | | | | | 1743 | |
| Në nivelin fillor | | | | | | | | | | | | 10288 | |
| Në nivelin e mesëm të ulët | | | | | | | | | | | | 8374 | |
| Në nivelin e mesëm të lartë | | | | | | | | | | | | 3946 | |
| Për të gjitha nivelet | | | | | | | | | | | | 24351 | |

Tabela 2. Numri i nxënësve sipas komuniteteve 2023-2024

| Etnia | Niveli i edukimit të hershëm | | Niveli fillor | | | | | Niveli i mesëm i ulët | | | | Niveli i mesëm i lartë | | |
|-------------------------|------------------------------|-------------|---------------|------|------|------|------|-----------------------|------|------|------|------------------------|------|------|
| | Parashkollorë | Parafillorë | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
| Shqiptarë | 136 | 1312 | 1732 | 1710 | 1743 | 1810 | 1740 | 1860 | 1731 | 1698 | 1774 | 1107 | 1120 | 1123 |
| Boshnjakë | 7 | 90 | 134 | 125 | 110 | 144 | 143 | 146 | 159 | 169 | 129 | 102 | 113 | 89 |
| Turq | 11 | 105 | 123 | 96 | 103 | 116 | 88 | 112 | 85 | 118 | 132 | 120 | 109 | 63 |
| Rom, ashkali, Egjiptian | 1 | 47 | 77 | 72 | 66 | 74 | 82 | 72 | 60 | 72 | 57 | 7 | 17 | 10 |

Tabela 3. Struktura e të punësuarve në arsim

| Nr. | Kuari | Shqiptarë | | Boshnjakë | | Turq | | Romë, ashkali, egjiptian | | Gjithsej | | Gjithsej |
|-----|---------------------|-----------|-----|-----------|----|------|----|--------------------------|---|----------|-----|----------|
| | | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| 1 | Edukator | 1 | 67 | | 9 | | 6 | | 3 | 1 | 85 | 86 |
| 2 | Mësues (I -V) | 101 | 397 | 52 | 22 | 1 | 32 | 1 | 1 | 155 | 452 | 607 |
| 3 | Arsimtar (VI-IX) | 361 | 334 | 80 | 30 | 15 | 21 | | | 456 | 385 | 841 |
| 4 | Mësimdhënës (X-XII) | 162 | 112 | 19 | 13 | 11 | 13 | | | 192 | 138 | 330 |
| 5 | Drejtor | 34 | 18 | 6 | 1 | | | | | 40 | 19 | 59 |
| 6 | Zv.drejtor | 3 | 2 | | | 3 | | | | 6 | 2 | 8 |
| 7 | Sekretar | 11 | 10 | | | | | | | 11 | 10 | 21 |
| 8 | Psikolog | 1 | 7 | | | | | | | 1 | 7 | 8 |
| 9 | Pedagog | 5 | 2 | | | | | | | 5 | 2 | 7 |
| 10 | Bibliotekist | 5 | 6 | | | | | | | 5 | 6 | 11 |

¹ <https://kk.rks-gov.net/prizren/City-guide/Geography.aspx>

| | | | | | | | | | | | | |
|----|-----------------|-----|-----|-----|----|----|----|----|----|------|------|------|
| 11 | Staf mbështetës | 193 | 21 | 22 | 11 | 5 | 5 | 13 | 19 | 233 | 56 | 289 |
| | Gjithsej | 877 | 976 | 179 | 86 | 35 | 77 | 14 | 23 | 1105 | 1162 | 2267 |

Nga analiza e të dhënave të ofruara nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, shqyrtimi i raporteve të ndryshme që i adresohen arsimit në këtë komunë, informacioneve të fituara nga vizita e disa shkollave, si dhe konsultimeve që janë realizuar gjatë takimeve të punës vërehet se sistemi arsimor në komunën e Prizrenit ka bërë përparime të konsiderueshme në disa fusha kyçe, por gjithashtu përballlet me sfida të mëdha që kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme. Kjo analizë është ndarë në shtatë fusha kryesore:

- Udhëheqja dhe Menaxhimi,
- Kultura dhe Mjedisi,
- Mësimdhënia dhe Nxënia,
- Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve, dhe
- Performanca e Nxënësve.
- Edukimi i hershëm
- Arsimi profesional

Secila nga këto fusha përmban një analizë të sukseseve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve, duke ndihmuar në krijimin e një pasqyre të qartë dhe të balancuar të gjendjes aktuale.

Udhëheqja dhe Menaxhimi analizon situatën që ekziston në strukturat udhëheqëse të shkollave, si dhe sfidat që ka komuna për të siguruar një udhëheqje efektive të shkollave. Vendosja e koordinatorëve të cilësisë dhe funksionalizimi i Këshillit të Nxënësve dhe Prindërve ka rritur transparencën dhe përfshirjen e komunitetit në procesin e vendimmarrjes. Decentralizimi i buxhetit të shkollave ka kontribuar në menaxhimin më të mirë të fondeve dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Nga ana tjetër, sfidat përfshijnë përplasjen e kompetencave ndërinstucionale dhe mungesën e një organogrami të qartë për DKA-në, duke krijuar paqartësi dhe vonesa në vendimmarrje. Përfitimi i pamjaftueshëm i donacioneve dhe subvencioneve ka kufizuar mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

Kultura dhe Mjedisi trajtojnë bashkëpunimin e shkollave me DKA dhe policinë e komunitetit, që ka krijuar një mjedis më të sigurt dhe të kontrolluar për nxënësit. Respektimi i diversitetit kulturor dhe përfshirja e komuniteteve në aktivitetet shkollore kanë kontribuar në një atmosferë të respektit dhe bashkëjetesës harmonike. Funksionimi i Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve (EPRBM) ka ndihmuar në parandalimin e braktisjes së shkollës. Dobësitë përfshijnë mungesën e kuzhinës qendrore për institucionet parashkollore dhe mungesën e politikave për sigurinë fizike në shkolla. Ndriçimi i papërshtatshëm rreth objekteve shkollore krijon probleme sigurie, dhe aktivitetet jashtëshkollore janë të pakta.

Mësimdhënia dhe Nxënia kanë parë përmirësime në respektimin e diversitetit të nxënësve dhe përdorimin e metodave fleksibile. Përzgjedhja dhe shpërblimi i nxënësve më të mirë ka motivuar përpjekjet dhe suksesin e tyre. Megjithatë, ndërprerja e rrjetit dhe mungesa e internetit kanë krijuar vështirësi në zhvillimin e mësimin të integruar dhe në përdorimin e teknologjisë. Procesi mësimor zhvillohet me vështirësi në konceptin e mësimdhënies së integruar dhe zhvillimit të kompetencave. Mungesa e bashkëpunimit të prindërve në procesin arsimor dhe moszbatimi i plotë i instrumenteve të vlerësimit janë dobësi që kërkojnë zgjidhje.

Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve ka bërë përparime me shumëllojshmërinë e trajnimeve dhe mundësinë e kyçjes së të gjithë mësimdhënësve në to. Mësimdhënësit e trajnuar në ECDL dhe IT kanë rritur aftësitë e tyre teknologjike dhe përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor. Funksionimi i ekipit komunal për implementimin e kurrikulës ka ndihmuar në zbatimin efektiv të reformave arsimore. Sfida kryesore është mungesa e trajnimeve adekuata sipas fushave të caktuara dhe neglizhenca e mësimdhënësve ndaj trajnimeve të OJQ-ve. Për t'i përmirësuar këto sfida, ekzistojnë mundësi të shumta për lidhjen e marrëveshjeve për punë praktike dhe përfshirjen në trajnime shtesë.

Në përmbledhje, ndërkohë që ka shumë suksese të rëndësishme në të gjitha fushat e sistemit arsimor në komunën e Prizrenit, është e domosdoshme të adresohen dobësitë ekzistuese dhe të shfrytëzohen mundësitë për përmirësim. Rreziqet e identifikuara duhet të menaxhohen me kujdes për të siguruar një sistem arsimor të drejtë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit.

Udhëheqja dhe Menaxhimi

Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave në komunën e Prizrenit kanë treguar përmirësime të dukshme në disa fusha, duke përfshirë ndërtimin e qerdheve të reja dhe vendosjen e koordinatorëve të cilësisë në shkolla. Këto përpjekje kanë ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të organizuar për nxënësit dhe stafin arsimor. Funksionalizimi i Këshillit të Nxënësve dhe Prindërve në nivel komunal ka përmirësuar përfshirjen e prindërve dhe nxënësve në procesin e vendimmarrjes, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë. Këto suksese janë thelbësore për krijimin e një sistemi arsimor më të drejtë dhe të barabartë, duke u siguruar që zëri i të gjitha palëve të dëgjohet dhe të merret parasysh.

Sfidat kryesore:

- Përplasja e kompetencave ndërinstitucionale
- Infrastruktura ligjore e kufizuar/mangët për rekrutimin e punonjësve
- Përfitimi i pamjaftueshëm i donacioneve/subvencioneve
- Nuk ndërveprohet mjaftueshëm me komunitetin (donator - biznesi, agjencitë etj)
- Mungesë e organogramit të DKA (riorganizimi)
- Kompensimi i punonjësve arsimorë përmes përbarimit ka shkaktuar krizë financiare në DKA)
- Kapacitete të pamjaftueshme profesionale për nivelet 0 deri 3 në komunë

Megjithatë, ekzistojnë disa dobësi që ndikojnë në efikasitetin e menaxhimit të arsimit në komunë. Përplasja e kompetencave ndërinstitucionale ka krijuar konfuzion dhe vonesa në vendimmarrje, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit. Mungesa e një organogrami të qartë për Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) ka rezultuar në paqartësi dhe mosefikasitet në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrative. Për më tepër, infrastruktura ligjore e kufizuar për rekrutimin e punonjësve ka sjellë mungesë të stafit të kualifikuar, duke kufizuar aftësinë për të ofruar një arsim cilësor.

Udhëheqësit e institucioneve edukative-arsimore në Komunën e Prizrenit e kanë kryer trajnimin e programeve në institucione të akredituara për udhëheqje arsimore. 268 punonjës arsimor janë të trajnuar për menaxhim dhe udhëheqje të shkollave në komunën e Prizrenit. Pavarësisht trajnimeve të kryera, udhëheqja dhe menaxhimi efektiv i institucioneve sërish mbetet sfida. Ngritja e mëtejshme profesionale për drejtuesit e shkollave, në mënyrë që t'i plotësojnë nevojat specifike në menaxhim dhe udhëheqje, është jetike. Vëzhgimi i performancës së drejtorëve të shkollave, me anë të proceseve siç janë vlerësimi i brendshëm

dhe i jashtëm, duke dhënë komente kthyesë tek drejtoret, është forma më e mirë që bën DKA për momentin, por që duhet të jetë konstante edhe më tutje. Funkcionimi efikas i Këshillave Drejtues të shkollave duhet të fuqizohet dhe më tej sepse ka shkolla ku Këshillat Drejtues nuk i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara. Menaxhimi dhe udhëheqja nuk mund të kenë rezultate të kënaqshme nëse nuk funksionojnë organet e shkollës.

Ndërkohë, përfitimi i pamjaftueshëm i donacioneve dhe subvencioneve ka kufizuar mundësitë për përmirësime të mëtejshme në arsim. Shkollat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të shkruar projekte dhe për të tërhequr fonde shtesë, duke penguar zhvillimin dhe inovacionin. Kjo situatë përkeqësohet nga mungesa e bashkëpunimit me komunitetin, përfshirë donatorët, bizneset dhe agjencitë, duke kufizuar kështu mbështetjen e nevojshme për përmirësimin e kushteve arsimore. Për më tepër, kompensimi i punonjësve arsimor përmes përmbarimit ka shkaktuar krizë financiare në DKA, duke kufizuar aftësinë për të investuar në përmirësime të nevojshme.

Tabela 4. Buxheti për arsimin parauniversitar në vitin 2023.

| Burimi | Pagat dhe mëditjet | Mallrat dhe shërbimet | Shpenzim et komunale | Subvencion et dhe transferet | Shpenzim et kapitale | Gjithsej |
|--------------------|---------------------------|-------------------------|----------------------|------------------------------|----------------------|------------------------|
| Grantet qeveritare | 16.276.763.4 ₃ | 1.846.731 | 230.000 | N/A | 1.702.000 | 20.055.49 ₄ |
| Të hyrat vetanake | 70.000 | 455.500 | | N/A | 384.495 | 909.995 |
| Gjithsej | 16.346.763 | 1.847.186. ₅ | 230.000 | N/A | 2.086.495 | 20.965.48 ₉ |

Pavarësisht këtyre sfidave, ekzistojnë mundësi të shumta për përmirësimin e menaxhimit të arsimit në komunë. Ngritja e kapaciteteve brenda komunës për orientim dhe këshillim në karrierë mund t'i ndihmojë nxënësve në zgjedhjen e rrugëve të tyre të ardhshme arsimore dhe profesionale. Zhvillimi i praktikës profesionale në institucione publike, përfshirë mësimin dual, mund të rrisë përgatitjen praktike të nxënësve dhe t'i bëjë ata më konkurrues në tregun e punës. Krijimi i qeverisjes së mirë në funksionalizimin e organeve qeverisëse në institucionet arsimore mund të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin, ndërsa shfrytëzimi i mundësive për bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare mund të sjellë burime dhe ekspertizë shtesë në arsim.

Digjitalizimi i të gjitha shërbimeve arsimore mund të rrisë efikasitetin dhe qasjen në arsim, duke përmirësuar menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve arsimore. Rritja e numrit të asistentëve dhe mësuesve mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta mund të përmirësojë përfshirjen dhe suksesin e këtyre nxënësve, duke siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje të barabartë në arsim.

Megjithatë, ekzistojnë disa rreziqe që duhen marrë parasysh. Interesimi i pakët i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për gjithëpërfshirje mund të çojë në përjashtim dhe pabarazi në arsim. Politikat e papërshtatshme të Ministrisë së Arsimit për rrjetëzimin/fuzionimin e shkollave mund të krijojnë paqartësi dhe të ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit. Përplasja dhe shpërputhja e ligjeve të arsimit mund të krijojnë konfuzion dhe vështirësi në zbatimin e politikave arsimore.

Shkathtësitë digjitale të pamjaftueshme nga komuniteti arsimor mund të kufizojnë përdorimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie. Shpërdorimi i pajisjeve dhe mjeteve digjitale nga nxënësit dhe mësimdhënësit mund të krijojë probleme disiplinore dhe të ulë efektivitetin e mësimdhënies. Përdorimi i inteligjencës artificiale nga nxënësit për qëllime jo të përshtatshme mund të krijojë sfida etike dhe disiplinore.

Gjithashtu, ekziston hapësirë për shpërdorim të realizimit të zonës së mbulueshmërisë, ku prindërit nuk regjistrojnë fëmijët në zonat e tyre të shkollave, duke krijuar pabarazi dhe mbingarkesë në disa shkolla. Arsimi nuk konsiderohet prioritet nga vendimmarrësit, duke kufizuar fondet dhe vëmendjen për përmirësime të nevojshme. Kontestet e pazgjidhura pronësore shkollore mund të pengojnë zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve arsimor në DKA mund të kufizojë aftësinë për t'i mbështetur dhe monitoruar shkollat në mënyrë efektive, ndërsa mungesa e mjeteve buxhetore mund t'i kufizojë mundësitë për investime dhe përmirësime në arsim.

Në përmbledhje, ndërkohë që ka shumë suksese të rëndësishme në udhëheqjen dhe menaxhimin e arsimit në komunën e Prizrenit, është e domosdoshme të adresohen dobësitë ekzistuese dhe të shfrytëzohen mundësitë për përmirësim. Rreziqet e identifikuara duhet të menaxhohen me kujdes për të siguruar një sistem arsimor të drejtë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë nxënësit.

Kultura dhe Mjedisi

Kultura dhe mjedisi në shkollat e komunës së Prizrenit janë elemente kyçe për krijimin e një ambienti arsimor të shëndetshëm dhe të frytshëm. Një nga sukseset më të mëdha është bashkëpunimi i shkollave me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) dhe policinë e komunitetit, duke krijuar një mjedis më të sigurt dhe të kontrolluar për nxënësit. Respektimi i diversitetit kulturor dhe përfshirja e të gjitha komuniteteve në aktivitetet shkollore kanë kontribuar në krijimin e një atmosfere të respektit dhe bashkëjetesës harmonike. Këto përpjekje kanë qenë thelbësore për promovimin e një kulture të qëndrueshme dhe të përfshirjes.

Funksionimi i Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve (EPRBM) ka ndihmuar në parandalimin e braktisjes së shkollës dhe në përfshirjen e nxënësve të rrezikuar, duke siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë sistemit arsimor. Bashkëpunimi i kujdestarëve të klasave me nxënës dhe bashkëpunimi i mirë me komunitetin kanë rritur mbështetjen dhe udhëzimin për nxënësit, duke përmirësuar performancën e tyre akademike dhe sjelljen. Ndërtimi i qerdheve të reja dhe zgjerimi i hapësirave për kopshte publike kanë krijuar mundësi të reja për edukimin e hershëm, duke përmirësuar cilësinë e arsimit që nga mosha e hershme.

Megjithatë, ka ende dobësi që ndikojnë në cilësinë e kulturës dhe mjedisit në shkolla. Mungesa e kuzhinës qendrore për institucionet parashkollore ka kufizuar mundësitë për ofrimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të rregullt për fëmijët. Nuk ka politikë për ofrimin e sigurisë fizike në shkolla, duke lënë hapësira për incidente dhe rreziqe të ndryshme. Infrastruktura e shkollave nuk është sipas standardeve për ndërtimin e kopshteve, duke krijuar kushte të papërshtatshme për fëmijët e vegjël. Mosfunksionimi i ndriçimit rreth objekteve shkollore ka krijuar probleme sigurie, veçanërisht gjatë orëve të errëta të ditës.

Aktivitetet jashtëshkollore në fushën e kulturës dhe mjedisit janë të pakta, duke kufizuar mundësitë për zhvillim të gjithanshëm të nxënësve. Mungesa e stafit mjekësor në shkolla ka krijuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore të shpejta dhe të specializuara. Mungesa e barrierave horizontale në rrugë afër shkollave ka krijuar rreziqe për sigurinë e fëmijëve gjatë lëvizjeve të tyre. Mungesa e hapësirave për të zhvilluar aktivitete jashtëkurrikulare ka kufizuar mundësitë për angazhimin dhe zhvillimin e talenteve të nxënësve. Mungesa e mirëmbajtjes së kabineteve ka ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Sfidat kryesore:


- Nuk ka politikë për ofrimin e sigurisë fizike në shkolla
- Infrastruktura nuk është sipas standardeve për ndërtimin e kopshteve
- Mungesa e hapësirave për të zhvilluar aktivitete jashtë kurrikulare
- Mungesa e mësimit përmes projekteve
- Prezenca e dukurive negative në shkolla

Tabela 5. Numri i shkollave që posedojnë masa të sigurisë.

| Vlerësimi i Sigurisë | | |
|--|----|----|
| Numri i shkollave që i posedojnë masat më poshtë: | Po | Jo |
| Roje fizike | 14 | 64 |
| Person të trajnuar për emergjenca | 24 | 55 |
| Person të trajnuar për ndihmë të parë profesionale | 21 | 56 |

Pavarësisht këtyre sfidave, ekzistojnë mundësi të shumta për përmirësimin e kulturës dhe mjedisit në shkolla. Funksionalizimi i grupeve dhe klubeve të ndryshme shkollore, si ato ekologjike, mund të rrisë angazhimin e nxënësve dhe të promovojë edukimin mbi mjedisin dhe qëndrueshmërinë. Krijimi i hapësirave të gjelbra mund të përmirësojë ambientin shkollor dhe të sigurojë hapësira të rehatshme për mësim dhe lojë. Ofrimi i një mjedisi të ngrohtë, miqësor, të pastër dhe të sigurt mund të rrisë mirëqenien dhe performancën e nxënësve.

Vendosja e sigurimit fizik në shkolla mund ta rrisë sigurinë dhe t'i parandalojë incidentet e ndryshme. Bashkëpunimi me komunitetin shkollor dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të shkollave mund të krijojnë kushte më të mira për mësim dhe zhvillim të gjithanshëm të nxënësve. Ndërtimi i terreneve sportive dhe funksionalizimi i bufeve në shkolla mund të promovojnë një stil të shëndetshëm jetese dhe të rrisin angazhimin e nxënësve. Organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për normat e sjelljes dhe investimet e drejtpërdrejta brenda dhe jashtë objekteve shkollore mund ta përmirësojnë atmosferën dhe cilësinë e jetës shkollore.



Grafiku 5. Numri i Shkollave që i Posedojnë Masat e Sigurisë.

Megjithatë, ekzistojnë disa rreziqe të cilat duhen marrë parasysh. Barrierat gjuhësore ulin nivelin e bashkëpunimit ndërmjet hisedarëve të arsimit, duke krijuar vështirësi në komunikim dhe përfshirje. Lokalet e papërshtatshme afër shkollave dhe prezencat e dukurive negative, si bullizmi dhe lokalet e lojërave, krijojnë një mjedis të pasigurt dhe të paqëndrueshëm për nxënësit. Mungesa e sinjalizimit në rrugët afër shkollave dhe pasiguria fizike e fëmijëve në këndin e lojërave janë probleme serioze që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Rezistenca e komunitetit për bashkëpunim dhe mosfunksionimi në praktikë i këshillave të prindërve janë sfida që kufizojnë përfshirjen dhe mbështetjen e nevojshme për përmirësimin e arsimit.

Në përmblendhje, ndërkohë që ka shumë suksese të rëndësishme në kulturën dhe mjedisin e shkollave në komunën e Prizrenit, është e domosdoshme të adresohen dobësitë ekzistuese dhe të shfrytëzohen mundësitë për përmirësim. Rreziqet e identifikuar duhet të menaxhohen me kujdes për të siguruar një mjedis arsimor të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë për të gjithë nxënësit.

Mësimdhënia dhe Nxënia

Mësimdhënia dhe nxënia janë elemente thelbësore për suksesin e sistemit arsimor në komunën e Prizrenit. Zhvillimi i zyrave mësimore dhe integrimi i teknologjisë kompjuterike me rrjet kanë rritur qasjen në burime dhe informacion, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve. Krijimi i mekanizmave mbështetës profesional për implementimin e kurrikulës në shkollë ka ndihmuar në zbatimin efektiv të reformave arsimore, duke siguruar që mësimdhënësit të kenë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për t'i zbatuar praktikën më të mirë pedagogjike.

Shkollat respektojnë diversitetin e nxënësve dhe përdorin metoda fleksibile që i përgjigjen nevojave të tyre, duke siguruar gjithëpërfshirje dhe barazi. Përzgjedhja dhe shpërblyerja e nxënësve më të mirë ka motivuar përpjekjet dhe suksesin e nxënësve, duke krijuar një kulturë të vlerësimit dhe përparimit. Monitorimi i mësimdhënësve nga Inspektorati i Arsimit ka siguruar përmbushjen e standardeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Organizimi i ligjëratave brenda aktiveve dhe bashkëpunimi me DKA kanë ndihmuar në përmirësimin e procesit mësimor dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në procesin mësimor ka siguruar një arsim gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

Sfidat kryesore:

- Mungon mekanizmi i bashkëpunimit të prindërve në shkollë, në procesin e planifikimit të kurrikulës me bazë në shkollë
- Mosbashkëpunimi me shkollë tjera
- Moszbatimi i instrumenteve të vlerësimit sipas udhëzimit administrativ
- Mungesa e kabineteve për lëndët natyrore
- Mungesa e internetit dhe ndërprerja e rrymës elektrike


Tabela 6. Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit 2023 – 2024.

| Nivelet | Shqiptarë | Boshnjakë | Turq | Romë, ashkalinj, egjiptianë |
|---|-----------|-----------|------|-----------------------------|
| Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm | 1448 | 97 | 116 | 48 |
| Gjithsej në nivelin shkollor | 8735 | 656 | 526 | 371 |
| Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët | 7063 | 603 | 447 | 261 |
| Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë | 3350 | 304 | 292 | 34 |

Tabela 7. Numri i nxënësve me nevoja të veçanta sipas komuniteteve në komunën e Prizrenit 2023-2024.

| Numri i nxënësve në punë me PIA 2023 – 2024 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|------------------------------|-------------|---------------|----|------|----|---|-----------------------|-----|------|----|------------------------|----|-----|
| Etnia | Niveli i edukimit të hershëm | | Niveli fillor | | | | | Niveli i mesëm i ulët | | | | Niveli i mesëm i lartë | | |
| | Parashkol-lor | Parafill-or | I | II | II I | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
| Shqiptarë | 2 | 8 | 9 | 7 | 16 | 14 | 6 | 15 | 18 | 9 | 13 | 4 | 7 | 5 |
| Boshnjakë | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Turq | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Rom, ashkali, Egjiptian | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Megjithatë, ka ende dobësi që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Ndërprerja e rrjetit dhe mungesa e internetit kanë krijuar vështirësi në zhvillimin e mësim të integruar dhe në përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor. Procesi mësimor zhvillohet me vështirësi të konceptit të mësimdhënies së integruar dhe të bazuar në zhvillimin e kompetencave. Mungesa e bashkëpunimit të prindërve në procesin e planifikimit dhe jetësimit të kurrikulës me bazë në shkollë ka ndikuar në efektivitetin e reformave arsimore. Moszbatimi i plotë i instrumenteve të vlerësimit dhe mungesa e kabineteve për lëndët natyrore kanë krijuar sfida për mësimdhënësit dhe nxënësit.



Grafiku 6. Numri i shkollave që kanë qasje në internet apo kabinet të kompletuar për nxënës.

Ndërkohë, mungesa e mbështetjes për nxënësit me sukses të dobët dhe mungesa e aktiviteteve shtesë për nxënësit më të mirë dhe më të suksesshëm kanë kufizuar mundësitë për përparim dhe zhvillim të gjithanshëm. Për më tepër, mungesa e mekanizmave për bashkëpunim efektiv midis shkollave dhe prindërve ka krijuar një hendek në përfshirjen e prindërve në procesin arsimor.

Të gjitha shkollat i kanë krijuar aktivet profesionale, të cilat funksionojnë në masë të madhe. Sfida për funksionimin e aktiveve profesionale paraqitet në shkollat me numër të vogël të punonjësve arsimor. Aktivet profesionale nuk i kanë të dokumentuara sa duhet: planifikimin dhe realizimin e programeve mësimore, vlerësimin e vazhdueshëm të nxënësve, përcaktimin e instrumenteve për vlerësimin e nxënësve në mënyrë që të dokumentohen rezultatet sipas planit zhvillimor të shkollës.

Tabela 8. Raporti mësimdhënës-nxënës në institucionet publike.

| Niveli | Komuna e Prizrenit | Republika e Kosovës |
|----------------------------------|--------------------|---------------------|
Ky koncept përfshin krijimin e një mjedisi ku mësuesit, nxënësit, prindërit dhe stafi tjetër shkollor bashkëpunojnë për të përmirësuar procesin mësimor. Duke inkurajuar bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv në mes tyre, kjo strategji ndihmon në rritjen e angazhimit të nxënësve dhe përmirësimin e performancës së tyre akademike.

Pajisja e shkollave me mjete të TIK dhe rrjete lokale:

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) ofrojnë mundësi të mëdha për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Pajisja e shkollave me pajisje moderne të TIK, si kompjuterë, tableta, dhe akses në internet, ndihmon në rritjen e aksesit të nxënësve në burime të reja mësimore dhe zhvillimin e aftësive të tyre në përdorimin e teknologjisë.

Furnizimi i shkollave me mjete elementare të konkretizimit (0-5):

Mjetet elementare të konkretizimit, si lojrat edukative, materialet artistike dhe librat për lexim, sigurojnë një ambient të pasur dhe stimulues për zhvillimin e fëmijëve në moshën e hershme. Këto mjete ndihmojnë në zhvillimin e aftësive motorike, aftësive gjuhësore si dhe në kreativitetin e fëmijëve.

Pajisja e shkollave me laboratorë të ndryshëm:

Laboratorët e shkencave, teknologjisë, inxhinierisë, matematikës dhe shkencave tjera ofrojnë një mjedis praktik për nxënësit për të eksperimentuar dhe aplikuar njohuritë e tyre teorike në praktikë. Pajisja e shkollave me laboratorë të mirëmbajtur dhe të pajisur me teknologji të fundit siguron një përvojë mësimore të pasur dhe të motivuar për nxënësit.

Këto përpjekje të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve synojnë të krijojnë një ambient të stimulueshëm dhe të përgatitur për zhvillimin e suksesshëm akademik dhe personal të nxënësve në shkolla.

3.2.4. Zhvillimi profesional i mësimeve

Objektivi Strategjik 4. Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësime cilësore

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësime cilësore është një proces i rëndësishëm dhe i përhershëm që synon të përmirësojë aftësitë dhe performancën e mësuesve dhe stafit shkollor për të ofruar një arsim cilësor dhe të përshtatshëm për nxënësit. Ky proces përfshin disa aspekte dhe strategji që përmirësojnë aftësitë mësimore dhe profesionale të të gjithë personelit shkollor.

Në fillim, trajnimet dhe zhvillimi profesional janë thelbësore për ndërtimin e kapaciteteve të mësuesve. Kjo përfshin trajnime periodike mbi metodat mësimore inovative, përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe strategjitë për menaxhimin e klasës dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta. Trajnimi i vazhdueshëm nxit rritjen e kompetencave dhe siguron që mësuesit të jenë të përgatitur për t'u përballur me sfidat e reja dhe për të përdorur metoda të avancuara mësimore.

Gjithashtu, ndarja e praktikave të mira dhe bashkëpunimi mes mësuesve dhe shkollave është një tjetër aspekt kyç. Duke ndarë përvoja dhe strategji efektive mësimore, mësuesit kanë mundësi të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të zhvillojnë një kulturë të përbashkët mësimore në komunitetin shkollor. Kjo përfshin organizimin e punëtorëve, takimeve profesionale dhe platformave për ndarjen e njohurive dhe ideve të reja.

Një element tjetër që ndihmon në ndërtimin e kapacitetit për mësime cilësore është përdorimi i vlerësimit dhe rishikimit të mësimit. Krijimi i mekanizmave për vlerësim të rregullt të performancës së mësuesve dhe nxënësve ndihmon në identifikimin e zonave për përmirësim dhe në përdorimin e strategjive të përshtatshme për të rritur cilësinë e mësimit dhe nxënies nëpërmjet rishikimit të programit mësimor dhe të metodave të përdorura.

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësime cilësore është një proces dinamik dhe i përhershëm që përfshin trajnimin, bashkëpunimin dhe përdorimin e mekanizmave të vlerësimit për të siguruar një arsim cilësor dhe të përshtatshëm për të gjithë nxënësit nëpërmjet inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Masat

Identifikimi i nevojave të mësimeve për trajnime

Për të filluar, është e rëndësishme identifikimi i nevojave të mësimeve për trajnime. Ky proces siguron që trajnimet janë të përshtatshme dhe adresojnë nevojat konkrete të mësuesve, duke përfshirë zhvillimin e aftësive të reja mësimore, përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), dhe menaxhimin e klasës.

Organizimi i trajnimeve në nivel të komunës dhe me bazë në shkollë

Organizimi i trajnimeve në nivel komunal dhe me bazë në shkollë ofron mundësi për mësuesit për të përmirësuar aftësitë e tyre në një mjedis të njohur dhe të përshtatshëm. Kjo gjithashtu inkurajon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave mes mësuesve të ndryshëm.

Nxitja e monitorimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të kolegëve

Shkëmbimi i përvojave dhe monitorimi i vazhdueshëm i praktikave mësimore ndihmon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Kjo mund të realizohet përmes grupeve të punës, takimeve profesionale dhe platformave për ndarjen e njohurive dhe strategjive të suksesshme.

Themelimi i Qendrës Didaktike dhe mbështetja e qendrës për ngritje profesionale

Qendrat didaktike ofrojnë mjete dhe resurse për të përmirësuar vazhdimisht aftësitë e mësuesve. Përmes trajnimeve, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të kurrikulave të përditësuara, qendrat didaktike mbështesin ngritjen profesionale të mësuesve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollat e tyre.

Krijimi i mekanizmave efikas për financimin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve
Financimi i sigurt dhe i qëndrueshëm për zhvillimin profesional të mësuesve siguron që programet dhe trajnimet janë të vazhdueshme dhe të përshtatshme për nevojat e shkollave dhe mësuesve.

Angazhimi i drejtorëve të shkollave për monitorim të vazhdueshëm të mësimdhënësve lidhur me zbatimin e metodologjive bashkëkohore

Drejtorët e shkollave luajnë një rol kyç në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollë. Ata duhet t'i monitorojnë vazhdimisht praktikat mësimore të mësuesve dhe të inkurajojnë përdorimin e metodologjive të fundit dhe më të mira në mësim.

Ngritja e kapaciteteve të shkollës për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve

Zhvillimi i aftësive të drejtorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe mësuesve për të vlerësuar performancën e mësimdhënësve përmirëson transparencën dhe përgjegjshmërinë në procesin e mësimdhënies.

Krijimi i mekanizmave funksional për stimulim të mësimdhënësve të suksesshëm

Nxitja dhe kompensimi i mësimdhënësve të suksesshëm përmes stimulimeve materiale dhe jo-materiale inkurajon motivimin dhe përkushtimin e tyre ndaj përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

3.2.5. Sigurimi i cilësisë

Objektivi Strategjik 5. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë është një proces që kërkon angazhim të qëndrueshëm dhe përkushtim të plotë nga të gjithë aktorët e edukimit. Ky proces përfshin një gamë të gjerë veprimesh dhe strategjish për të siguruar një ambient mësimor sa më efektiv dhe të përshtatshëm për nxënësit, duke i përgatitur ata për të ardhmen dhe për t'i zhvilluar aftësitë e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe inovative. Një aspekt kyç i përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies është trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional i mësuesve. Përmes trajnimeve të rregullta dhe të përshtatshme, mësuesit i përmirësojnë aftësitë e tyre mësimore, mësojnë për metodat e fundit dhe përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të përmirësuar mësimin dhe të nxënies. Koordinimi i këtyre trajnimeve në nivel shkollor dhe komunal siguron që nevojat e individëve dhe të shkollës në përgjithësi të adresohen me efikasitet. Gjithashtu, një tjetër komponent i rëndësishëm është sigurimi i infrastrukturës së nevojshme dhe pajisjeve të shkollave. Kjo përfshin sigurimin e mjeteve moderne të TIK, laboratorëve të pajisur mirë dhe mjeteve të

nevojshme për lëndën e edukatës fizike. Një infrastrukturë e mirë e shkollës siguron që mësuesit dhe nxënësit të kenë burime të mjaftueshme për të realizuar mësimin dhe eksplorimin e shkencës dhe teknologjisë në mënyrë efektive. Në anën tjetër, për të siguruar cilësinë e mësimdhënies, është i rëndësishëm ndërtimi i mekanizmave të vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë në nivel shkollor dhe komunal. Kjo përfshin vlerësimin e rregullt të performancës së mësuesve dhe nxënësve, si dhe përdorimin e feedback-ut për të përmirësuar metodat dhe praktikatat mësimore. Përmes këtyre mekanizmave, shkollat mund të rrisin standardet dhe të sigurojnë se cilësia e mësimdhënies është në nivel të lartë dhe të përshtatshëm për të gjithë nxënësit. Për të krijuar një mjedis të përkushtuar ndaj përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, është e rëndësishme të fuqizohen aktorët profesionistë në shkollë dhe të inkurajohet bashkëpunimi i tyre në nivel profesional. Drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë kanë një rol të rëndësishëm në drejtimin dhe mbështetjen e këtyre përpjekjeve, duke siguruar që çdo iniciativë dhe zhvillim është në përputhje me nevojat dhe qëllimet e përbashkëta për një arsim të cilësisë së lartë.

Masat

Përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë

Koordinatorët e cilësisë luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në nivel lokal. Ata i koordinojnë përpjekjet për përmirësimin e praktikave mësimore dhe implementimin e standardeve të cilësisë nëpërmjet trajnimeve dhe mbështetjes së mësuesve.

Caktimi i fondeve për ndërtim, renovim, zgjerim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës shkollore

Sigurimi i mjeteve financiare për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike të shkollave është kritik për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për mësimdhënie. Kjo përfshin investime në klasat e reja, bibliotekat, laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.

Furnizimi i shkollave me kompjuterë dhe infrastrukturë të TIK dhe mjeteve të tjera të nevojshme

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) ofrojnë shumë mundësi për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Pajisja e shkollave me kompjuterë, akses në internet dhe platforma të TIK ndihmon në rritjen e aksesit të nxënësve në burime mësimore moderne dhe efikase.

Pajisje e shkollave me pako të veglave për lëndën e edukatës fizike

Mjetet e përshtatshme për edukatë fizike, si veglat sportive dhe mjetet sportive të ndryshme, kontribuojnë në zhvillimin e shëndetshëm dhe të përshtatshëm fizik të nxënësve. Kjo përfshin sigurimin e mjeteve për ushtrime fizike dhe lojëra sportive të cilat ndihmojnë në zhvillimin motorik dhe shëndetin e përgjithshëm të nxënësve.

Ndërtimi dhe fuqizimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në nivel të shkollës dhe të komunës

Implementimi i sistemeve të vlerësimit të cilësisë dhe monitorimit të performancës së mësimdhënësve dhe nxënësve siguron që cilësia e mësimdhënies të mbetet në nivel të lartë.

Kjo përfshin vlerësimin e rregullt dhe rishikimin e programit mësimor, si dhe përdorimin e feedback-ut për përmirësimin e metodave dhe strategjive mësimore.

Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla

Trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional i mësuesve dhe stafit shkollor kontribuon në rritjen e aftësive dhe kompetencave të tyre. Kjo përfshin zhvillimin e programeve trajnuese të përshtatshme për nevojat specifike të mësuesve dhe mbështetjen për përdorimin e metodave mësimore të inovative dhe efektive.

3.2.6. Edukimi i hershëm

Objektivi Strategjik 6. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm

Për të arritur një bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm, është e rëndësishme të krijojmë një mjedis të përkushtuar për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve edukative për fëmijët tanë.

Bashkëpunimi cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm është një pjesë thelbësore e përpjekjeve për të siguruar një bazë arsimore të fortë dhe të përshtatshme për fëmijët në moshën e tyre parashkollore. Ky bashkëveprim i koordinuar dhe i përfshirë përfshin një numër aktorësh që punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta arsimore dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore për fëmijët tanë. Bashkëpunimi cilësor fillon me një koordinim të mirë të përpjekjeve dhe planifikim të përbashkët të aktiviteteve arsimore. Aktorët kyçë si prindërit, mësuesit, administratorët shkollorë, autoritetet lokale dhe sektori privat bashkohen nëpërmjet dialogjeve të hapura për të hartuar strategji dhe plane të përbashkëta që të përmirësojnë ofertën arsimore. Bashkëpunimi efikas siguron që resurset financiare dhe njerëzore të përdoren në mënyrë të zgjuar dhe të efektshme. Kjo përfshin investime të përbashkëta në infrastrukturë, pajisje teknologjike, trajnime për mësuesit dhe zhvillim të programeve inovative mësimore për të përshpejtuar zhvillimin arsimor dhe rritjen e cilësisë së mësimin. Gjithaashtu bashkëpunimi cilësor inkurajon ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe komunitetit lokal në proceset arsimore. Duke organizuar takime informuese, punëtori për prindër, dhe pjesëmarrje në vendimmarrje arsimore, ne sigurojmë mbështetje të gjerë dhe angazhim të komunitetit për t'i përmirësuar shërbimet arsimore për fëmijët.

Masat

Stimulimi i hapjes së institucioneve të edukimit parashkollor përmes partneriteteve publiko-private

Partneritetet publiko-private ofrojnë një mundësi të rëndësishme për të zgjeruar qasjen në arsimin parashkollor duke përfshirë sektorin privat. Kjo mund të përfshijë subvencione, lehtësime fiskale apo mbështetje të tjera për organizatat private që ofrojnë shërbime arsimore parashkollor. Bashkëpunimi i këtyre partneriteteve mund të rrisë kapacitetin dhe disponueshmërinë e vendeve në institucionet parashkollor.

Bashkëpunimi me MASH/T/SIA për licencimin e IPEH

Bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet e arsimit publik për licencimin dhe rregullimin e institucioneve private të edukimit të hershëm siguron që standardet minimale arsimore janë të plotësuara dhe respektuar. Kjo përfshin zbatimin e rregullave të sigurisë, kushteve të mjedisit dhe cilësisë së programit mësimor për fëmijët.

Ndërgjegjësimi i komunitetit për përfshirje në edukimin e hershëm dhe parafillor

Informimi dhe ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes për këtë fazë kritike të zhvillimit të fëmijëve. Aktivitete të tilla mund të përfshijnë takime informuese, fushata ndërgjegjësuere dhe pjesëmarrje aktive të prindërve në procesin arsimor të fëmijëve të tyre.

Bashkëpunim i shtuar me institucionet private të edukimit të hershëm

Shtimi i bashkëpunimit me institucionet private të edukimit të hershëm përmirëson qasjen dhe diversifikon ofertën arsimore për fëmijët. Kjo mund të përfshijë shkëmbimin e praktikave të mira, trajnime për mësuesit dhe koordinimin e aktiviteteve mësimore për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e mësimdhënies në të gjitha nivelet.

3.2.6. Arsimi profesional

Objektivi Strategjik 7. Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës

Ndërlidhja e mirë e arsimit profesional me tregun e punës është një aspekt kritik për të siguruar që programet dhe trajnimet profesionale ofrojnë aftësitë dhe njohuritë që kërkohen në botën e punës aktuale. Institucionet e arsimit profesional duhet të jenë të përfshira në konsultime të vazhdueshme me industrinë dhe sektorin privat për t'i identifikuar nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës. Kjo përfshin identifikimin e fushave të zhvillimit të shpejtë teknologjik, si dhe aftësitë dhe kompetencat e reja që punëdhënësit kërkojnë. Bazuar në informacionin e përcjellur nga tregu i punës, institucionet e arsimit profesional duhet të adaptojnë dhe të zhvillojnë kurrikula dhe programe të studimit për t'i përmbushur këto kërkesa. Kjo përfshin përdorimin e metodave mësimore të përshtatshme, trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve për të siguruar që ata i kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të mësuar materiale relevante dhe të fundit në fushën e tyre. Bashkëpunimi i ngushtë me industrinë dhe organizatat e ndryshme punëdhënëse mund të përfshijë praktika të punës, vizita në vendet e punës, projekte bashkëpunuese, dhe mundësi për punësim të sigurt për studentët pas përfundimit të studimeve. Kjo ndihmon në sigurimin e një eksperience të pasur praktike dhe njohuri të qëndrueshme për studentët, si dhe në garantimin e rritjes së aftësive të kërkuara nga tregu i punës. Institucionet e arsimit profesional duhet të kenë mekanizma të vlerësimit dhe monitorimit të efikasitetit të trajnimeve të tyre. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit të trajnimit në karrierën dhe zhvillimin e studentëve, si dhe vlerësimin e suksesit të ndihmës për t'i arritur qëllimet e vendosura për përshtatshmëri të aftësive dhe pritjet e tregut të punës. Ndërlidhja e mirë e arsimit profesional me tregun e punës jo vetëm që i përmirëson mundësitë e punësimit të nxënësve, por gjithashtu kontribuon në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe në përshtatjen e saj me zhvillimin global të tregut të punës. Ky bashkëpunim mund të krijojë një rrjet të fortë të bashkëpunimit midis sektorit arsimor dhe atij të biznesit, duke siguruar që aftësitë dhe njohuritë e fituara nga studentët janë në përputhje me pritjet dhe kërkesat e kohës.

Masat

Identifikimi i nevojave të tregut të punës

Institucionet e arsimit profesional duhet të jenë të përfshira në konsultime të vazhdueshme me industrinë dhe sektorin privat për t'i identifikuar nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës. Kjo përfshin identifikimin e fushave të zhvillimit të shpejtë teknologjik, si dhe aftësitë dhe kompetencat e reja që i kërkojnë punëdhënësit.

Përshtatja e kurrikulave dhe programeve të studimit

Bazuar në informacionin e përcjellur nga tregu i punës, institucionet e arsimit profesional duhet të adaptojnë dhe të zhvillojnë kurrikula dhe programe të studimit për t'i përmbushur këto kërkesa. Kjo përfshin përdorimin e metodeve mësimore të përshtatshme, trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve për të siguruar që ata i kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të mësuar materiale relevante dhe të fundit në fushën e tyre.

Pjesëmarrja aktive e industrisë në procesin mësimor

Bashkëpunimi i ngushtë me industrinë dhe organizatat e ndryshme punëdhënëse mund të përfshijë praktika të punës, vizita në vendet e punës, projekte bashkëpunuese, dhe mundësi për punësim të sigurtë për studentët pas përfundimit të studimeve. Kjo ndihmon në sigurimin e një eksperiencë të pasur praktike dhe njohuri të qëndrueshme për studentët, si dhe në garantimin e rritjes së aftësive të kërkuara nga tregu i punës.

Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të trajnimit

Institucionet e arsimit profesional duhet të kenë mekanizma të vlerësimit dhe monitorimit të efikasitetit të trajnimeve të tyre. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit të trajnimit në karrierën dhe zhvillimin e studentëve, si dhe vlerësimin e suksesit të ndihmës për të arritur qëllimet e vendosura për përshtatshmëri të aftësive dhe pritjet e tregut të punës.

3.3. Analiza e rrezikut

Analiza e rrezikut bëhet me qëllim të parandalimit të situatave të papritura që mund ta vënë në rrezik zbatimin e planit strategjik dhe përmban në vete vlerësimin për mundësinë e paraqitjes së një rreziku, të ndikimit që ai rrezik mund të ketë, si dhe elaborimin e masave për parandalimin ose minimizimin e rrezikut. Një analizë e tillë është prezantuar në tabelën 7.

Vlerësimet janë dhënë sipas objektivave strategjike, duke dalluar tri nivele të gjasës për paraqitjen e rrezikut (“e vogël”, “mesatare” dhe “e madhe”), si dhe tri nivele analoge të ndikimit që rreziku i tillë mund të ketë për zbatimin e planit zhvillimor (“i vogël”, “mesatar”, “i madh”).

Nga tabela shihet se një rrezik të rëndësisë së veçantë paraqet mungesa e përkrahjes nga MASHT për zbatimin e kurrikulës së re, pasi bëhet fjalë për një qasje krejtësisht të re, rreth së cilës nuk ekziston përvoja në Kosovë. Po ashtu, rrezik paraqet mirëmbajtja jo e mirë e pajisjeve të TIK-ut, që zhvlerëson investimet e bëra në këtë fushë, pasi pajisjet e blera nuk mund të shfrytëzohen në mënyrë efektive.

Në çdo situatë, DKA duhet të bëj kujdes që analiza e rrezikut të rishikohet në intervale të rregullta kohore, duke i bërë ndryshimet dhe plotësimet e duhura në të, në mënyrë që rrezikut të minimizohet sa më shumë që të jetë e mundshme.

Tabela 13. Analiza e rrezikut për Planin Zhvillimor të Arsimit

| Rreziku | Gjasa | Ndikimi | Masat parandaluese |
|---|---|---------------------------------------|---|
| | 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe | 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh | |
| 1.3. Ndërtimi i strukturës për menaxhim efektiv të arsimit në DKA | 2 | 3 | <ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e autoriteteve komunale në procesin e zhvillimit të strukturës së re të DKA |
| 1.5. Rishikimi dhe racionalizimi i rrjetit të shkollave në komunë | 1 | 3 | <ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e ekzekutivit të komunës në fillet e zbatimit të rrjetit të shkollave |
| 2.1. Analiza e gjendjes së sigurisë në shkolla dhe marrja e masave për plotësimin e nevojave më prioritare | 2 | 2 | <ul style="list-style-type: none"> Marrja në konsideratë e të gjitha aspekteve të sigurisë, përfshirë menaxhimin e emergjencave mjekësore dhe nga shkaqet natyrore |
| 3.2. Pajisja e shkollave me mjete të TIK dhe rrjete lokale | 1 | 3 | <ul style="list-style-type: none"> Instalimi filterëve kufizues në pajisjet e TIK |
| 4.4. Themelimi i Qendrës Didaktike dhe mbështetja e qendrës për ngritje profesionale dhe të shkollave në të cilat organizohet ZhPM | 2 | 3 | <ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e ekzekutivit të komunës dhe autoriteteve tjera komunale në procesin e përzgjedhjes së lokacionit për qendër didaktike |
| 4.5. Krijimi i mekanizmave efikas për financimin e ZhPM | 2 | 2 | <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi një politike të favorshme për mësimdhënësit për bashkëfinancimin e zhvillimit profesional |
| 6.1. Stimulim i hapjes së institucioneve të edukimit parashkollor përmes partneriteteve publiko-private | | | <ul style="list-style-type: none"> Përfshirje më e madhe e SIA dhe autoriteteve komunale |

4. Plani i veprimit dhe buxheti

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit, duke filluar nga viti 2025 dhe duke vazhduar deri në përfundim të vitit 2027. Si plani i veprimit, ashtu edhe buxheti janë të karakterit orientues dhe duhet të rishikohen para fillimit të çdo viti fiskal. Po ashtu, para fillimit të çdo viti fiskal duhet të përpilohet një plan i detajuar i aktiviteteve për atë vit.

Disa shpenzime për realizimin e Planit Zhvillimor duhet të mbulohen nga burimet vetanake të Komunës, ndërsa disa të tjera nga Buxheti i Kosovës ose donatorët. Sidoqoftë, shpenzimet që do të mbulohen nga burimet vendore duhet të përfshihen në buxhetin e Komunës për vitin vijues, ndërkaj për shpenzime që mendohet të mbulohen nga burimet e donatorëve, duhet komunikuar me donatorët përkatës. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të buxhetit të nevojshëm për realizimin e Planit Zhvillimor të Komunës sipas shtatë objektivave strategjike të tij.

Tabela 14. Përmbledhja e buxhetit të Planit Zhvillimor të Arsimit

| Fusha | Buxheti | | | |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| | 2025 | 2026 | 2027 | Totali |
| 1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës | €46 500,00 | €56 800,00 | €72 800,00 | €176 100,00 |
| 2. Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore | €397 000,00 | €391 000,00 | €2 191 000,00 | €2 979 000,00 |
| 3. Përmirësim domethënës i mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla | €361 000,00 | €375 000,00 | €375 000,00 | €1 111 000,00 |
| 4. Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore | €211 000,00 | €151 000,00 | €151 000,00 | €513 000,00 |
| 5. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla | €180 000,00 | €206 000,00 | €237 200,00 | €623 200,00 |
| 6. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm | €2 000,00 | €2 000,00 | €2 000,00 | €6 000,00 |
| 7. Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës | €21 500,00 | €21 500,00 | €21 500,00 | €64 500,00 |
| | €1 219 000 | €1 203 300 | €3 050 500 | €5 472 800 |

Në vijim është dhënë plani i detajuar i aktiviteteve dhe vlerësimi i kostos buxhetore sipas objektivave dhe masave të planit zhvillimor të arsimit.

Objektivi 1: Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës

| Masa 1.1 Funkcionalizimi dhe fuqizimi i këshillave drejtues të shkollave | | | | | | | | | | | |
|---|--|--------------------------|-----------------------|--------------------------------------|---|----------------------|-------|-------|------|------|--------|
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/ organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.1.1 | Rifreskimi i anëtarëve të këshillave drejtues që përfaqësojnë komunën përmes vendosjes së kritereve bazë nga DKA | I – III 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.1.2 | Organizimi i trajnimit për këshillat drejtues për bazat e menaxhimit (funktionet dhe kompetencat) dhe qeverisjes në arsim, përfshirë buxhetimin bazë | Çdo vit | Drejtorët e shkollave | DKA | Gjithsej 150 të trajnuar x 300 Eur | 15000 | 15000 | 15000 | 0 | 0 | 45000 |
| 1.1.3 | Krijimi i sistemit të raportimit të rregullt për mbajtjen e mbledhjeve të këshillave drejtues nëpër shkolla | I – III 2025 | Drejtorët e shkollave | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.1.4 | Krijimi i mekanizmit për llogaridhënie në financa dhe buxhet | I – III 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.1.5 | Hartohen udhërrëfyes për personelin e KDSH-ve | I – III 2025 | DKA | Donatorët OJQ-të | Angazhimi i konsulentit x 1200 Eur Botimi i udhërrëfyesve 500 copë x 3 Eur = 1.500 Eur | 2700 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2700 |

| 1.1.6 | Motivimi i prindërve për pjesëmarrje në KDSH-të | III, X të secilit vit | DKA | Donatorët OJQ-të | 2 fushata në vit x 300 Eur për fushatë | 600 | 600 | 600 | 0 | 0 | 1800 |
|-----------------------|---|--------------------------|--------------|--------------------------------------|--|----------------------|--------------|--------------|----------|----------|--------------|
| 1.1.7 | Përzgjedhja e prindërve në KDSH sipas kritereve të përcaktuara (suksesi, autoriteti, rrjeti, etnia në shkollat me gjuhë mësimore të shumta, ndërmarrësia, koha e ndarë për pjesëmarrje) | I – III 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.1.8 | Ndarja e burimeve për KDSH-të (hapësirë dhe TI) | I – III 2025 | DKA | Komuna Donatorët OJQ-të | Rekomandohet hapësira e dedikuar për Qendër Didaktike 3.000 Eur (kompjuterë, tavolina etj) | 3000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3000 |
| 1.1.9 | Rrjetëzimi i KDSH-ve të shkollave | Që nga IX 2025 | Shkollat | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.1.10 | Sigurimi pjesëmarrjes së KDSH në takimet dhe aktivitetet e shkollave | Që nga I 2025 | Shkollat | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nën-Totali 1.1 | | | | | | 21300 | 15600 | 15600 | 0 | 0 | 52500 |
| Masa 1.2 | Ngritja e kapaciteteve për udhëheqje dhe menaxhim | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/ organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.2.1 | Përzgjedhja e personelit arsimor për trajnime për udhëheqje në arsim | Që nga IV 2025 | Shkolla | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| 1.2.2 | Organizimi i trajnimeve për udhëheqje arsimore | Që nga IV 2025 | Shkolla | DKA Donatorët | Tri grupe x 30 persona x 100 Eur për person | 3000 | 3000 | 3000 | 0 | 0 | 9000 |
|-----------------------|---|--------------------------|--------------|--------------------------------------|---|----------------------|-------------|-------------|----------|----------|--------------|
| 1.2.3 | Krijimi i mekanizmit për llogaridhënie në menaxhim | Që nga I 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.2.4 | Takime të rregullta koordinuese dhe të shkëmbimit të përvojave me drejtorë shkollash | Që nga I 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.2.5 | Përmbledhja dhe publikimi i punimeve që përmirësojnë menaxhimin në arsim | Që nga IX 2025 | DKA | Donatorët | Një publikim i përmbledhjeve në vit x 3.000 Eur | 3000 | 3000 | 3000 | 0 | 0 | 9000 |
| 1.2.6 | Përditësimi i vazhdueshëm i PZhSh-ve të shkollave, në raste të shkollave gjeografikisht të afërta konsultime të përbashkëta | Që nga I 2025 | Shkollat | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nën-Totali 1.2 | | | | | | 6000 | 6000 | 6000 | 0 | 0 | 18000 |
| Masa 1.3 | Ndërtimi i strukturës për menaxhim efektiv të arsimit në DKA | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/ organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.3.1 | Analiza e strukturës dhe i organogramit ekzistues | IX, X, XI 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| 1.3.2 | Rishikim funksional i strukturës menaxhuese në DKA | IX, X, XI 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
|-----------------------|--|--------------------------|--------------|--------------------------------------|--|----------------------|----------|----------|----------|----------|----------|
| 1.3.3 | Rishikimi i shpërndarjes së detyrave | IX, X, XI 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.3.4 | Zhvillimi i strukturës së re të organogramit i përshtatur ndryshimeve në arsim dhe nevojat e shkollave | XII 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.3.5 | Harmonizimi i strukturës së re sipas katalogut të punës | XII 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.3.6 | Aprovimi i organogramit nga asambleja komunale | XII 2024 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.3.7 | Rekrutimi i personelit shtesë | Që nga I 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nën-Totali 1.3 | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Masa 1.4 | Krijimi i mekanizmave për vlerësim dhe stimulim të strukturave udhëheqëse të shkollave | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/ organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.4.1 | Organizimi i vizitave në shkollat e tjera | Që nga IV 2025 | Shkollat | DKA | Një vizitë x 300 Eur x 4 vizita në vit | 1200 | 1200 | 1200 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.2 | Krijimi i kriterëve/standardeve për strukturat funksionale | Që nga IV 2025 | DKA | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| 1.4.3 | Shpërblimet publike vjetore për strukturat më të suksesshme | Që nga IV 2025 | DKA | Shkollat | Një ngjarje publike në vit x 2000 Eur | 2000 | 2000 | 2000 | 0 | 0 | 0 - |
|--|--|--------------------------|--------------|--------------------------------------|---|----------------------|-------------|-------------|----------|----------|-------------|
| Nën-Totali 1.4 | | | | | | 3200 | 3200 | 3200 | 0 | 0 | 9600 |
| Masa 1.5 Rishikimi dhe racionalizimi i rrjetit të shkollave në komunë | | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/ organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.5.1 | Analiza e gjendjes në të gjitha shkollat dhe paralelet e ndara ku funksionojnë paralelet e kombinuara | Që nga IV 2025 | DKA | Komuna MASHTI | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.2 | Sigurimi i informatave plotësuese për numrin e mundshëm të fëmijëve për të paktën tri gjeneratat pasuese dhe të mësimdhënësve, duke përcjellë trendin e lëvizjes demografike | Që nga IV 2025 | DKA | Zyra e ofiqarisë | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.3 | Inicimi i debateve me grupe të interesit duke filluar nga komuniteti | Që nga IX 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.4 | Organizimi i transportit për bartjen e nxënësve deri në shkollën e afërt | Që nga I 2026 | DKA | Komuna | 4 shkolla në 2026 me rritje progresive në 12 shkolla në 2027 Një shkollë x 4000 Eur x 12 shkolla | 16000 | 32000 | 48000 | 0 | 0 | 96000 |
| 1.5.5 | Sistemimi i punonjësve të arsimit në shkolla tjera | Që nga I 2026 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | - |

| | | | | | | | |
|-----------------------|--|--------------|--------------|--------------|----------|----------|--------------|
| Nën-Totali 1.5 | | 16000 | 32000 | 48000 | 0 | 0 | 96000 |
|-----------------------|--|--------------|--------------|--------------|----------|----------|--------------|

| | | | | | | |
|-------------------------------|--------------|--------------|--------------|----------|----------|---------------|
| Totali i Objektivit 1: | 46500 | 56800 | 72800 | 0 | 0 | 176100 |
|-------------------------------|--------------|--------------|--------------|----------|----------|---------------|

Objektivi 2: Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore

| Masa 2.1 Analiza e gjendjes së sigurisë në shkolla dhe marrja e masave për plotësimin e nevojave më prioritare | | | | | | | | | | | |
|---|--|--------------------------|--------------|--|--|----------------------|-----------|-------|------|------|-----------|
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/or organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.1.1 | Formimi i ekipit për siguri në nivel të DKA-së | Që nga I 2025 | DKA | Drejtoria e emergjencave | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.1.2 | Analizimi i gjendjes së sigurisë në shkolla dhe dhënia e rekomandimeve | Që nga I 2025 | DKA | Drejtoria e emergjencave | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.1.3 | Hartimi planeve të emergjencës për secilën shkollë | Që nga III 2025 | DKA | Drejtoria e emergjencave | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.1.4 | Përditësimi i shkollave me mjetet e nevojshme të sigurisë (Aparate kundër zjarrit, ndihma e parë etj.) | Që nga III 2025 | DKA | Drejtoria e emergjencave | 30 shkolla x 2000 Eur | 2000 0 | 2000 0 | 20000 | 0 | 0 | 6000 0 |
| 2.1.5 | Përditësimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë në shkolla | Që nga III 2025 | Shkollat | DKA | Nga 20 shkolla në vit x 1000 Eur | 2000 0 | 2000 0 | 20000 | 0 | 0 | 6000 0 |
| 2.1.6 | Formimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në kuadër të shkollave | Që nga III 2025 | Shkollat | DKA | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.1.7 | Organizimi i trajnimeve për ekipet për parandalim dhe reagim ndaj dhunës | Që nga III 2025 | Shkollat | DKA | 60 persona x 100 Eur për person në vit | 6000 | 6000 | 6000 | 0 | 0 | 6000 |

| 2.1.8 | Krijimi i ekipeve shkollore për përgjigje të shpejtë ndaj emergjencave me natyrë mjekësore dhe trajnimi i tyre | Që nga IX 2025 | Shkollat | DKA | 3 grupe me nga 30 persona x 100 Eur | 9000 | 9000 | 9000 | 0 | 0 | 6000 |
|-----------------------|--|--------------------------|--------------|--|--|----------------------|-------------------|--------------|----------|----------|--------------------|
| 2.1.9 | Krijimi i protokolleve për emergjencat në shkolla | Që nga IX 2025 | DKA | Shkollat | Angazhimi i konsulencës dhe i Drejtorisë së Emergjencave | 6000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6000 |
| 2.1.10 | Furnizimi i shkolla me pajisje të emergjencave | Që nga I 2026 | DKA | Komuna Donatorët | 60 objekte shkollore x 1000 Eur | 2000 0 | 2000 0 | 20000 | 0 | 0 | 6000 0 |
| 2.1.11 | Fuqizimi i EPBR (Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësëve) | Që nga I 2025 | Shkollat | DKA | Trajnimi për EPBRM, 120 persona x 50 Eur në vit | 6000 | 6000 | 6000 | 0 | 0 | 1800 0 |
| Nën-Totali 2.1 | | | | | | 8700 0 | 8100 0 | 81000 | 0 | 0 | 2490 00 |
| Masa 2.2 | Ndërtimi i terreneve dhe i sallave të edukatës fizike | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/or organizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.2.1 | Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për terrene sportive dhe salla të edukatës fizike | Që nga IX 2024 | DKA | Shkollat | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.2.2 | Hartimi i projekteve për terrene sportive | Që nga I 2025 | DKA | Komuna DKRS | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| 2.2.3 | Hartimi i projekteve për salla të edukatës fizike | Që nga IV 2025 | DKA | Komuna DKRS | | | | | | | |
|-----------------------|---|--------------------------|--------------|--------------------------------------|-----------------------------------|----------------------|--------------------|---------------------|----------|----------|---------------------|
| 2.2.4 | Ndërtimi i terreneve sportive | Që nga VI 2025 | DKA | Komuna DKRS | Nga 3 terrene në vit x 20000 Eur | 6000 0 | 6000 0 | 60000 | 0 | 0 | 1800 00 |
| 2.2.5 | Ndërtimi i sallave të edukatës fizike | Që nga IX 2025 | DKA | Komuna DKRS Donatorët | Nga një sallë në vit x 250000 Eur | 2500 00 | 2500 00 | 250000 | 0 | 0 | 7500 00 |
| 2.2.6 | Ndërtimi i nje pishine shkollore për shfrytëzim të të gjitha shkollave të Komunës | III 2027 | DKA | Komuna Donatorët | | | | 180000 0 | 0 | 0 | 1800 000 |
| Nën-Totali 2.2 | | | | | | 3100 00 | 3100 00 | 211000 0 | 0 | 0 | 2730 000 |
| Masa 2.3 | Hartimi i planit për mirëmbajtje teknike të shkollave | | | | | | | | | | |
| Kodi | Aktiviteti | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/or ganizata mbështetëse | Përshkrimi i kostos | B U X H E T I (EURO) | | | | | |
| | | | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.3.1 | Formimi i grupit të punës për planin e mirëmbajtjes | Që nga I 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.3.2 | Analizimi i gjendjes teknike të të gjitha shkollave në komunë | Që nga I 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.3.3. | Hartimi i planit të mirëmbajtjes teknike të shkollave dhe plani i buxhetit | Që nga IV 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.3.4 | Përcaktimi i prioriteteve | Që nga IV 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | | |
|-----------------------|--------------------------------|----------------|-----|--------|--|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| 2.3.5 | Bërja e kërkesave për financim | Që nga IV 2025 | DKA | Komuna | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nën-Totali 2.3 | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**Totali i Objektivit 2: 3970 3910 391000 0 0 1179
00 00 000**

Objektivi 3: Përmirësim domethënës i mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla

| Masa 3.1 | | Fuqizimi i modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku" | | | | | | | | | |
|-----------------|---|--|--------------|--------------------------------------|----------------------|----------------------|------|------|------|------|--------|
